



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2018:059499

Datë: 15.03.2019

Numri i dokumentit: 00247260

P.nr.55/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË DEÇAN, gjyqtari Sulltan Dobraj, e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, në lëndën penale kundër të pandehurit I. GJ., i akuzuar sipas PTH nga Peja me aktakuzën **PP/II.nr.146/2018 te dt.22,02,2018**, për veprën penale te vjedhje e rëndë ne bashkekryerje nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 te KPRK, pas mbajtjes se seancës së shqyrtimit gjyqësorë, ne prezencën e prokurorit Muharrem Bajraktari, e pandehurit dhe mbrojtësit te tij. Av. Gëzim Baloku, ne te njëjtën ditë me **dt.07.11.2018** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 09,11,2018 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri I. GJ. i lindur me dt...., i biri i A. dhe nënës F. e vajzërisë L., me numër personal, shqiptar, shtetas i Kosovës.

Konform dispozitës ligjore nga nenit 363 paragraf 1 nen paragraf 1.1 te KPP-ës,

REFUZOHET AKTAKUZA

Për shkak se:

Me dt. 23.05.2016 ne mbrëmje ne kohe te pacaktuar në shkollën fillore te mesme te ulët “L....”, me qellim të përvetësimit te kundërligjshëm për veti duke përdorur forcën me një mjet te fortë fillimisht e dëmtojnë derën e zyrës së drejtorit, hynë brenda, i marrin qelsat e kabinetit te informatikës, pastaj marrin katër video projektor dhe 1 laptop te cilët ishin donacion nga bashkimi evropian nga zyra e drejtorit te shkollës marrin një laptop ne vlerë prej 450 euro, me qrast largohen nga aty pa u vërejtur nga askush.

- **me çka kishte për te kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë në bashkëkryerje nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK- së.**

Shpenzimet procedurale penale bijën në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Për shkak se prokurori ka hequr dorë nga aktakuza PP/II.nr.146/2018 të dt.22,02,2018 për pjesën që ka të bëjë me të pandehurin I. GJ..

E dëmtuara SHMU "L..." për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bijnë barrë e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

PTH nga Peja me akuzën **PP/II.nr.146/2018 të dt.22,02,2018** ka akuzuar të pandehurit L. B. dhe I. GJ. nga Deçani, për veprën penale të vjedhjes së rëndë në bashkëkryerje nga neni 327 par.1. nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, ka propozuar të caktohet dhe të mbahet seanca shqyrtimit gjyqësore të administrohen të gjitha provat e duhura e me në fund të pandehurit të shpallen fajtor dhe të dënohen në baze të ligjit si dhe të detyrohen në pagesën e shpenzimeve procedurale-penale.

Gjykata me dt.30.03.2018 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin shqyrtim i pandehuri L.B. ka pranuar fajësinë për vjedhjen e rëndë dhe ka deklaruar se veprën penale me të cilën akuzohet nuk e ka kryer me I.in por me dy persona të tjerë.

Gjykata me dt.30.03.2018 e ka veçuar procedurën penale andaj të pandehurin I. GJ. ndaj të cilët procedura penale është zhvilluar nën numrin P.nr.55/2018.

Gjykata më dt.07.11.2018 ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin gjyqësorë ku prokurori i shtetit ka deklaruar se pas administrimit të provave sidomos katër dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësorë të cilët kishin blerë sende të cilat janë vjedhur në shkollën "L...." në Deçan, në përgjigjeje të tyre asnjëri nuk deklaroi se blerjen e këtyre sendeve të vjedhura në shkollën filllore e ka blerë nga i akuzuari I.GJ.. Poashtu të njëjtit dëshmitar në përgjigjeje të tyre u deklaruan se gjatë blerjes së këtyre sendeve me asnjë formë nuk ka qenë i përfshirë në formë shitje apo diçka të ngjajshme i akuzuari I.GJ., edhe nga shkresat e lendes e sidomos nga mbrojtja që ka dhënë i akuzuari L.B. ku i njëjti përshkruan personat me të cilën ka kryer veprën penale në dëm të shkollës filllore nuk e përmend të akuzuarin I.GJ., prandaj duke u gjindur para kësaj situate e në

mungese te provave se i njëjti e ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 ne dëme te shkollës fillore, si prokuror i shtetit tërhiqem nga ndjekja penale në mungesë te provave e po ashtu e tërheq aktakuzën PP/II.nr, 146/2018 te dt.22.02.2018 për pjesën që ka te bëjë me I. GJ..

Për shpenzimet e procedurës penale gjykata ka vendosur konform nenit 454 paragraf 1 te KPP-së .

Nga sipërpërmendur e ne vështrim me dispozitën e nenit 363 paragraf 1 nën paragraf 1.1 te KPP-ës, është vendosur si ne dispozitivin e aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË DEÇAN
P.nr.55/2018 te dt.09.11.2018

Sekretare juridike,
Sabiha Hoxha

G J Y Q T A R I
Sulltan Dobraj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej **15 ditësh** Gjykatës se Apelit ne Prishtinë, pas pranimit te këtij aktgjykimi, e përmes kësaj gjykate.